

DOKUMENT SHPJEGUES PËR PROCEDURËN E ANKIMIT

- **Njohja me informacion publik**

- 1- Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet.
- 2- Bashkia Mallakastër (Autoritet publik) është i detyruar të informojë kërkuesin nëse ka ose jo në zotërim informacionin e kërkuar.
- 3- Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentit.

- **E drejta për informim dhe procedura për paraqitjen e kërkesës për informacion**

- 1- Kërkesa për informim bëhet me shkrim dhe dërgohet dorazi, me postë ose me postë elektronike, duke paraqitur saktë identitetin e kërkuesit dhe nënshkrimin e tij.
 - 1.1- Kërkesa për informim duhet të përmbajë:
 - ✓ emrin dhe mbiemrin e kërkuesit;
 - ✓ adresën postare ose elektronike ku kërkohet të dërgohet informacioni;
 - ✓ përshkrimin e informacionit që kërkohet;
 - ✓ formatin në të cilin preferohet informacioni;
 - ✓ çdo të dhënë që kërkuesi gjykon se mund të ndihmojë në identifikimin e informacionit të kërkuar.
 - 2- Autoriteti publik trajtojn kërkesën për informim në zbatim të ligjit nr 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt të jetë e mundur, por jo me vonë se 10 ditë pune në raste normale dhe deri në 15 ditë pune në raste të vecanta sipas volumit të dokumenteve të kërkuara nga dita e dorëzimit të saj, përveç rasteve kur ligji i posacëm e parashikon ndryshe.

- 3- Kur kërkesa është e paqartë në lidhje me përmbajtjen dhe natyrën e saj, Autoriteti Publik kontakton menjëherë personin për të bërë sqarimet e nevojshme por gjithnjë jo më vonë se 48 orë nga data e paraqitjes së kërkesës.
- 4- Në qoftë se pas shqyrtimit të kërkesës autoriteti publik konstaton se nuk e zotëron informacionin e kërkuar, ai, jo më vonë se 10 ditë kalendrike nga data e dorëzimit të kërkesës, ia dërgon atë autoritetit kompetent, duke e vënë në dijeni edhe kërkuesin.
- 5- Dhënia e informacionit mund të bëhet kundrejt një tarife, të përcaktuar më parë dhe të bërë publike nga autoriteti publik në faqen e tij të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut.
- 6- Qytetarët e regjistruar rregullisht në skemat e ndihmës shoqërore, si dhe subjektet përfituese, sipas ligjit nr. 10 039, datë 22.12.2008, “Për ndihmën juridike”, të ndryshuar, e përfitojnë informacionin falas deri në një numër të caktuar faqesh për çdo kërkesë ose në vlerën ekuivalente kur informacioni jepet në një format tjetër
- 7- E drejta e informimit kufizohet vetëm sipas rasteve të parashikuara në nenin 17 të Ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”.

*** E drejta për ankim dhe procedura e ankimit**

- 1- Çdo person, kur çmon se i janë shkelur të drejtat e parashikuara nga ky ligj, ka të drejtë të ankohet në rrugë administrative pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, në përputhje me këtë ligj dhe Kodin e Procedurave Administrative.
- 2- Ankimi administrativ pranë Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale bëhet brenda 30 ditëve punë nga dita kur:
 - ✓ ankuesi ka marrë njoftim për refuzimin e informacionit;
 - ✓ ka kaluar afati i parashikuar në këtë ligj për dhënien e informacionit.
- 3- Ankimi në gjykatë
 - ✓ kërkuesi ose autoriteti publik ka të drejtë ta ankimoje vendimin e komisionerit në gjykatën administrative kompetente.